



01 Nr. 2118
Datë 28.06.2016

Në bazë të nenit 12, nenit 24, dhe nenit 40 pika.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/5 qershor 2008, nenit 5 dhe nenit 19, të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike nr. 03/L -048, dhe nenit 55 pika 1, të Statutit të Komunës së Rahovecit 01Nr 569/1 të dt. 16.12.2010, Propozimit të Kryetarit të Komunës me nr. Prot. 2118, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2016, merr këtë :

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORË (KAB) SIPAS QARKORES SË PARË 2017/1 PËR VITET 2017-2019

Neni 1

Me këtë miratohen kufijtë buxhetorë (Korniza Afatmesme Buxhetore) sipas Qarkores së Parë 2017/1 për vitet 2017-2019 me numër të protokollit 01/966 të datës 13.05.2016, të Ministrisë së Financave të Kosovës.

Neni 2

Kuvendi pas shqyrtimit të kufijve buxhetorë ka dhënë vërejtje sa i përket planifikimit të të hyrave vetanake për vitin 2017, ne nuk pajtohemi me limitet e Qarkores 2017/1 ku planifikimi është 1,247,732.00 €, dhe rekomandojmë që planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2017 të jetë i njëjtë sikur në vitin 2016, respektivisht në shumën 1,158,014.00.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web – faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani